



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:142521

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05389567

KPPP.nr.53/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përbarimore të kreditorit të përbarimit “NLB” Prishtina Sh.A., (trashëgimtare juridike e Kasabankës), me seli në rr.“Rexhep Luci”, nr.5, në Prishtinë, e përfaqësuar nga Debt Loan Recovery L.L.C, kundër të debitorit N.P.T.Sh “Besiana Trade”, me numër unik identifikues 80178778, dhe seli në fshatin Vrellë e Goleshit në Lipjan, duke vendosur lidhur me kërkesën për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të përbaruesit privat Sefer Arifi me seli në Gjilan, jashtë seancës me datë 22 shkurt 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar kërkesa për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm e datës 14.12.2017 e ushtruar nga përbaruesi privat Sefer Arifi me seli në Gjilan, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan.

A r s y e t i m

Përbaruesi privat Sefer Arifi me seli në Gjilan, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, pran të cilit zbatohet përbarimi, më 14.12.2017 ka parashtruar kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për debitorin N.P.T.Sh “Besiana Trade” me seli në fshatin Vrellë e Goleshit në Lipjan. Në kërkesë ka sqaruar se kreditori “NLB” Prishtina Sh.A., (trashëgimtare juridike e Kasabankës), me seli në Prishtinë e ka plotësuar propozimin e tij për përbarim, ndërsa Përbaruesi ka nxjerr urdhrin përbarimor. Më tej ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se debitori ka vdekur, ku është evidentuar dhe në certifikatën e vdekjes. Tutje ka shtuar se sipas procesverbalit të datës 19.01.2016, i përpiluar nga Gjykata

Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, është kërkuar nga familjarët që të caktojnë përfaqësuesin e përkohshëm për debitorin-pronarin Ismet Berisha. Ka cekur se familjarët e të ndjerit kanë deklaruar se nuk pranojnë ta përfaqësojnë dhe për më tepër organi përmbarues, pas pranimi të lëndës E.nr.152/2012, ka bërë edhe tentimin e dytë lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe sipas procesverbalit të datës 07.12.2017, të përpiluar nga organi përmbarues, bashkëshortja e debitorit Fetije Berisha, nuk ka marr përgjegjësi dhe nuk ka pranuar që ta përfaqësoj bashkëshortin e saj të ndjerë.

Përmbaruesi kërkesën për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm e ka bazuar në nenin 35 para. 3 dhe 4 të LPP-së.

Me nenin 35 të LPP-së, paragrafin 2 është paraparë se *“Në rastet tjera të ndërprerjes së procedurës, të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, Gjykata mundet, po qe se e lejojnë rrethanat e rastiit një gjë të tillë, sipas propozimit të palës apo sipas detyrës zyrtare që të caktojë vazhdimin e procedurës duke ia emëruar përfaqësuesin e përkohshëm palës për të cilën ka të bëjë shkakun nga i cili vjen gjerë te ndërprerja e procedurës.”*, ndërsa në paragrafin 4 ka përcaktuar se *“Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përmbarimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përmbarimore. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veprojë në interes të debitorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe Gjykata në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues”*. Sipas dispozitave të lartcekura, gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm për palën duke u bazuar në propozimin e palës ose sipas detyrës zyrtare, kur plotësohen kushtet e caktuara.

Neni 2 i LPP-së në paragrafin 1.6 ka përkufizuar se me termin palë kuptohet “*kreditori apo debitori në procedurën përmbaruese*”, ndërsa në paragrafi 1.3 me termin kreditori kuptohet “*personi, kredia e të cilit realizohet në procedurë të përmbarrimit të detyrueshëm*”, kurse në paragrafi 1.4 me termin debitorit kuptohet “*personi kundër të cilit realizohet kredia*”, ndërsa në paragrafin 1.11 ka sqaruar se me termin përmbaruesi privat kuptohet “*personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbarrimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbarrim*”.

Rrjedhimisht, konform dispozitave të lartcekura, Përmbaruesi nuk është palë në procedurë, rrjedhimisht nuk paraqet subjekt procedural i cili përfshihet në definicionet ligjore të nenit 35 të LPP-së për të paraqitur propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Përveç kësaj, nenet e pjesë së dytë të LPP-së në kreun IV (nenet 337 deri 347), të cilët i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit privat, nuk e kanë paraparë asnjë normë juridike nga e cila do të rezultonte e drejta e përmbaruesit privat për të paraqitur kërkesë që palës së caktuar t’i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Ndërsa sa i përket mundësisë nga neni 35 i LPP-së që gjykata sipas detyrës zyrtare t’i caktoj palës përfaqësues të përkohshëm, gjykata sqaron se kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin konkret. Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm sipas detyrës zyrtare vetëm në rastet kur gjykata paraqitet si organ përmbarues, pra vetëm në rastet kur propozimi për përmbarrim sipas ligjit duhet të parashtrohet në gjykatë e jo te përmbaruesi privat. Në rastet tjera, gjykata vetëm e vlerëson kërkesën e palës së autorizuar për të kërkuar caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe nxjerrë vendim duke u bazuar në atë kërkesë.

Andaj për këto arsye gjykata vlerëson se Përmbaruesi nuk ka të drejtë të paraqes kërkesë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për asnjërën palë, si dhe gjykata nuk është e autorizuar në këtë rast të caktoj sipas detyrës zyrtare përfaqësues të përkohshëm, meqë procedura nuk është duke u zhvilluar në gjykatë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.53/22, datë 28.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate